

An abstract digital circuit pattern composed of various geometric shapes and lines in shades of blue and cyan. The pattern includes straight lines, right-angle turns, small circles, squares, and chevrons, all set against a dark blue background. The elements are scattered across the upper two-thirds of the page, creating a sense of complex, interconnected technology.

SHKATHTËSITË FINANCIARE

Publikuesi

Platforma "Biznesi Im" ofrohet nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe është zhvilluar nga projekti „Qasja në treg dhe shërbimet e digjitalizimit të biznesit për kompanitë e Kosovës (ACCESS)“, financuar nga Austrian Development Cooperation (ADC) dhe bashkëfinancuar nga Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Ministria e Ekonomisë (ME).

Deklarata e përjashtimit të përgjegjësisë

Kjo broshurë është krijuar për të ofruar informacione të dobishme mbi temën që diskutohet. Informacionet në këtë broshurë nuk zëvendësojnë këshillime specifike, shërbime këshilluese, këshilla ligjore dhe tatimore. Ne nuk marrim përsipër dhe nuk ofrojmë asnjë garanci të çfarëdo lloji, në lidhje me saktësinë, mjaftueshmërinë, vlefshmërinë, besueshmërinë, apo disponueshmërinë e çdo informacioni në broshurë. Prandaj, çdo përgjegjësi e autorëve përjashtohet.

1. AFTËSITË BAZIKE FINANCIARE PËR BIZNESE

Vetëm gjysma e bizneseve fillestare mbijetojnë përvjetorin e tyre të pestë. Ndërmarrësit që investojnë në ngritjen e aftësive të tyre financiare kanë më shumë gjasa për të performuar më mirë se sa konkurrenca e tyre e drejtpërdrejtë. Pa aftësi financiare është thjesht më e vështirë të planifikosh buxhetin ashtu siç duhet, të marrësh vendime të mençura, dhe t'i menaxhosh në mënyre efikase resurset e biznesit. Secili ndërmarrës, qoftë për fillimin apo zgjerimin e biznesit, duhet të ketë njohuri minimale mbi aspektet financiare të biznesit. Aftësitë financiare janë shtylla kryesore e çdo menaxheri/e/ndërmarrësi/e, nëse ai/ajo dëshiron të jetë i suksesshëm në biznesin e tij/saj. Këto aftësi ndihmojnë:

- Të mësoni si të krijoni buxhetin
- Të përgatiteni për taksat
- Të qëndroni të organizuar
- Të analizoni strukturën e fitimit dhe shpenzimeve
- Të merrni vendime më të mira
- Të ulni stresin
- Të përfitoni një përmbledhje të nivelit të lartë për shëndetin financiar të biznesit tuaj

Financat e biznesit manifestohen përmes tre raporteve/pasqyrave kryesore financiare që janë të rëndësishme për të gjitha bizneset:

- 1 Bilanci i suksesit
- 2 Bilanci i gjendjes
- 3 Pasqyra e rrjedhës së parasë

Nëse keni njohuri mbi këto tre raporte, atëherë jeni në rregull. Shumica e pronarëve të rinj të nuk kanë njohuri për to. Seksionet e mëposhtme japin sqarime të detajuara për secilin raport.

1.1 Bilanci i Suksesit

Bilanci i Suksesit, i quajtur ndryshe edhe Pasqyra e Fitimit dhe Humbjes, tregon të hyrat dhe shpenzimet e ndërmarrjes për një periudhë të caktuar kohore. Raportet mujore, tremujore dhe vjetore të Fitimit dhe Humbjes tregojnë profitabilitetin e një biznesi. Le të marrim një shembull të Bilancit të Suksesit dhe si duket i njëjti:

Formula e Bilancit të Suksesit :
Fitimi = Të hyrat - Shpenzimet

Le ta thjeshtojmë këtë:

- Të hyrat janë shuma bruto e mjeteve që realizoni nga shitja e produkteve dhe shërbimeve. Është shuma totale e të hyrave që një biznes ka realizuar para se të zbriten shpenzimet.
- Kostoja e mallrave të shitura, ose KMSH, është kategoria kryesore e shpenzimeve, pasi që tregon koston t drejtpërdrejtë të produkteve dhe/ose shërbimeve të shitura.

<https://youinc.com/content/leadership/financial-literacy-a-starter-guide-for-entrepreneurs>

<https://quickbooks.intuit.com/ca/resources/finance-accounting/financial-literacy-101-you-dont-know-what-you-dont-know/>

- Shpenzimet janë mjetet që ndërmarrja juaj shpenzon për stafin (pagat), rrymën, internetin, shërbimet komunale, marketingun, karburantet, materialin e zyrës, etj.
- Fitimi është ajo që mbetet pasi që nga të hyrat totale zbritet KMSH dhe të gjitha shpenzimet tjera. Kjo shifër paraqet fitimin tuaj të vërtetë.

Më poshtë është një shembull i Bilancit të Suksesit

Bilanci i suksesit	2020
Të hyrat	
Shitja e produkteve	50.000,00
Të hyrat (total)	50.000,00
Kosto e mallit të shitur (KMSH)	
Kosto e blerjes së produkteve	30.000,00
KMSH (total)	30.000,00
Fitimi Bruto	20.000,00
Shpenzimet	
Pagat	9.600,00
Rryma	1.200,00
Interneti	240,00
Sherbimt komunale	360,00
Marketingu	1.000,00
Karburantet	600,00
Materiali i zyrës	600,00
Shpenzimet (total)	13.600,00
Profiti para zhvelërsimit, interesit dhe taksave	6.400,00
Zhvelërsimi	2.000,00
Profiti para interesit dhe taksave	6.400,00
Interesi	600,00
Tatimi në të ardhura të korporatave (10%)	580,00
Profiti/Humbja (neto)	5.800,00

Marzha e fitimit

12%

Shënim:

- Zhvlerësimi është vlera monetare e një asemi, e cila zvogëlohet me kalimin e kohës për shkak të përdorimit, konsumit dhe vjetërsimit. Kjo ulje matet si zhvlerësim. Makineritë, pajisjet, ndërtesat janë ndër shembujt e aseteve që zhvlerësohen brenda një periudhe të caktuar kohore.
- Tatimi në të ardhura të korporatave në Kosovë është 10% dhe i paguhet Administratës Tatimore të Kosovës.

1.2 Bilanci i gjendjes

Bilanci i gjendjes është një pasqyrë momentale financiare e biznesit tuaj. Ai tregon gjendjen e përgjithshme financiare të ndërmarrjes suaj, përfshirë këtu të gjitha mjetet kapitalin dhe detyrimet.

Formula e bilancit të gjendjes:
Mjetet = Detyrimet + Kapitali

- Mjetet (Asetet) janë mjetet fikse dhe mjete rrjedhëse që posedon ndërmarrja juaj në mënyrë që të prodhojë përfitime të ardhshme ekonomike. Mjete fikse mund të jenë ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, ndërsa mjete rrjedhëse mund të jenë stoqet, llogaritë e arkëtueshme, dhe paratë e gatshme.
- Detyrimet janë obligimet e ndërmarrjes suaj përfshirë këtu borxhet afatshkurtra, borxhet afatgjata, si dhe llogaritë e pagueshme.
- Kapitali përfshinë mjetet e investuare të pronarit në ndërmarrje, si dhe fitimet e pa shpërndara të viteve të kaluara si dhe fitimin / humbjen e vitit aktual.

Më poshtë është një shembull i një Pasqyre të Bilancit të Gjendjes

Bilanci i suksesit	2020
Mjetet / Mjetet fikse	
Ndërtesa	0,00
Makineri	10.000,00
Paisje	10.000,00
Mjetet fikse (total)	20.000,00
Zhvelërsimi i akumuluar	2.000,00
Mjetet fikse (neto)	18.000,00
Mjetet rrjedhëse	
Stoqe	22.000,00
Llogari të arktueshme	2.000,00
Para të gatshme dhe banka	6.000,00
Mjete rrjedhëse (total)	30.000,00
Mjete (total)	48.000,00

Kapitali dhe Detyrimet	
Detyrimet	
Llogarit e pagueshme	800,00
Kredi dhe detyrime afatgjata	6.400,00
Detyrime tjera	6.000,00
Detyrimet (total)	7.800,00
Kapitali	
Kapitali vetanak	35.000,00
Fitimi i pashpërndare	0,00
Grantet	0,00
Profiti/Humbja e vitit aktual	5.800,00
Kapitali (total)	41.000,00
Kapitali dhe Detyrimet (Total)	48.800,00

1.3 Pasqyra e rrjedhës së parasë

Pasqyra e rrjedhës së parasë tregon se si mjetet monetare lëvizin brenda dhe jashtë biznesit. Është një nga pasqyrat më të dobishme të menaxhimit financiar.

- **Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative, paraqet ndryshimin në mes parase së pranuar nga aktivitet operative dhe parase së paguar për aktivitetet afariste. Aktivitetet afariste janë transaksione që përfshijnë blerjen apo prodhimin e produkteve dhe shërbimeve dhe shitjen dhe distribuimin e këtyre produkteve dhe shërbimeve deri te konsumatorët.**

Ashtu sikurse qarkullimi i gjakut është thelbësor për funksionimin e duhur të një jete, ashtu është edhe qarkullimi i parave për biznesin. Nëse gjaku nuk qarkullon mirë në të gjitha pjesët e organizmit dhe në sasi të mjaftueshme, do të krijojë probleme të mëdha shëndetësore. Është pothuajse identike me një ndërmarrje, në atë mënyrë që nëse rrjedha e parase nuk ecën siç duhet, ndërmarrja do të përballet me probleme të mëdha që mund të çojnë në pamundësi për të paguar detyrimet dhe të sjellin ndërmarrjen në falimentim përfundimtar.

Le të marrim një shembull tjetër të thjeshtë të rrjedhjes së parave gjatë një muaji ose gjatë një viti: Një familje me pesë anëtarë, dy të rritur dhe tre fëmijë. Rrjedha hyrëse e parave janë të ardhurat që prindërit marrin nga puna e tyre, si paga dhe të ardhura të tjera. Daljet e parave janë shpenzimet për të cilat familja paguan, përfshirë ushqimin që ata blejnë, pagimin e shërbimeve, pushimet e familjes, blerjen e rrobave, librave, etj. Nëse rrjedha monetare (të ardhurat) janë më të larta se daljet e parave (shpenzimet), atëherë kemi rrjedhë pozitive të parase, dhe anasjelltas, nëse rrjedha monetare (shpenzimet) janë më të larta se rrjedha hyrëse e parave (të ardhurat) kemi rrjedhë negative të parase. Një familje, ashtu si edhe një biznes, gjithmonë duhet të përpiqet të ruajë rrjedhën pozitive të parase, në mënyrë që të evitohet ndonjë krizë eventuale financiare.

Më poshtë është paraqitur një shembull i pasqyrës financiare

Cash Flow	2020
Hyrja e cash-it	
Shitja	48.000,00
Mjete vetanake	35.000,00
Kredi	8.000,00
Të hyra tjera	0,00
Hyrja e cash-it (total)	91.000,00
Dalja e cash-it / Shpenzimet	
Kosto e mallit të shitur (KMSH)	30.000,00
Stoqe	21.200,00
Pagat	9.600,00
Rryma	1.200,00
Interneti	240,00
Sherbime komunale	360,00
Marketingu	1.000,00
Karburantet	600,00
Materiali i zyres	600,00
Investimet	
Paisje	10.000,00
Makineri	10.000,00
Kreditë	
Pagesa e kredisë	1.600,00
Interesi	600,00
Tatimi	
Tatimi në të ardhura të korporatave	580,00
Dalja e cash-it (total)	87.580,00
Teprica/Deficiti (-)	3.420,00
Gjendja e cash-it në fillim të periudhes	2.580,00
Gjendja e cash-it në fund të periudhes	6000,00

1.4 Kthimi në investim (RoI)

Kthimi në investim (RoI) është një raport midis fitimit neto dhe kostos së investimit gjatë një periudhe kohore. Një ROI i lartë nënkupton një investim të duhur. Si masë e performancës, ROI përdoret për të vlerësuar efikasitetin e një investimi ose për të krahasuar efikasitetin e disa investimeve të ndryshme. Në terma ekonomikë, është një mënyrë e lidhjes së fitimeve me kapitalin e investuar.

Formula e Kthimit në Investim (ROI)
Fitimi neto / Totali i Investimit * 100

Një shembull i thjeshtë është kur vendosni të blini një apartament me qëllim lëshimin me qira të tij. Le të supozojmë se apartamenti që keni blerë ju kushton 70,000 EUR. Çmimet neto të qirasë shkojnë rreth **300 EUR** në muaj.

ROI për apartamentin tuaj do të ishte:

300 EUR çmimi i qirasë neto x 12 muaj = 3,600 EUR fitim në vit, pra;

ROI për këtë apartament është:

3,600 EUR fitim neto / 70,000 kosto e investimit x 100 = 5.1% në vit. Do të thotë që duhen 19,44 vjet për të kthyer paratë që keni investuar në blerjen e kësaj banese. Sa më i lartë ROI, aq më shpejt do të ktheni investimin tuaj.

1.5 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh) është një taksë e konsumit e vendosur në një produkt sa herë që shtohet vlera në secilën fazë të zinxhirit të furnizimit, nga prodhimi deri në pikën e shitjes. Në Kosovë, norma standard e TVSh-së është 18%, ndërsa norma e reduktuar e TVSh-së është 8%. Kjo taksë paguhet nga konsumatorët përfundimtarë për çdo produkt apo shërbim që ata blejnë. Le të marrim një shembull të një dyqani tregtar të këpucëve.

Çmimi furnizues i këpucëve ka qenë **70 Euro**. Dyqani tregtarë ka shtuar edhe **10%** diferencë në çmim për fitimin e planifikuar. Kjo ka rritur çmimin në **77 Euro**. Çmimi prej **77 euro** paraqet bazën për të llogaritur TVSH, pra **77 euro x 18% = 90,86**. Në këtë rast vlera e TVSH është **13.86 Euro**.

2.0 INSTITUCIONET TJERA RELEVANTE

2.1 Fondi pensional

Fondet pensionale menaxhojnë fondet e krijuara nga kontributet e punëtorëve përgjatë kohës së punës së tyre. Në Kosovë ky fond quhet Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) (www.trusti.org). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive individuale të kursimit të pensioneve.

Punëtori dhe punëdhënësi paguajnë nga 5% të pagës bruto për kontribute, të cilat akumulohen në llogari personale të pacenueshme. Të gjitha kontributet në llogaritë individuale janë pronë e kontribuuesve, ndërsa FKPK përbën veglën që mundëson qasjen në tregjet e ndryshme për të bërë investime, të cilat realizohen përmes menaxhuesve të fondeve.

Punëdhënësit deklarojnë obligimin për pagesë të kontributeve pensionale përmes sistemit online të deklarimit në ATK. Deklarimi bëhet përmes ngarkimit të listës së të punësuarve në sistemin e deklarimit online, EDI, në ATK. Pas deklarimit, sistemi online prodhon fletëpagesat përkatëse përmes të të cilave bëhet pagesa në cilëndo prej bankave komerciale ose institucioneve të licencuara për pagesa të këtilla.

2.2 Administrata Tatimore e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës është institucioni përgjegjës për mbledhjen e të gjitha taksave nga paguesit e taksave (<http://www.atk-ks.org/>). Taksat ndryshojnë bazuar në llojin e biznesit dhe qarkullimin vjetor. Administrata tatimore zbaton tre taksa kryesore: Taksa e Vlerës së Shtuar (TVSh); Taksa e të Ardhurave të Korporatave (TAK); Taksa e të Ardhurave Personale (TAP).

2.3 Bankat komerciale

Në Kosovë sot operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale (Banka për Biznes, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Ekonomike, Komercijalna Banka, NLB Prishtina, Procredit Bank, Raiffeisen Bank Kosovo, Türkiye İş Bankası, T.C. Ziraat Bankası Kosova dhe TEB S.H.A.) dhe përbëjnë 65% të asetëve totale të sektorit financiar. Bankat e Kosovës i shërbejnë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës duke ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve financiare. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancinë bankare, letër kredi, e-banking.



ACCESS

Market Access and Business Digitalization
Services for Kosovo Companies

Platforma „**Biznes Im**“ është zhvilluar
me përkrahjen e projektit **ACCESS**

Financuar nga

 Austrian
Development
Cooperation

Bashkëfinancuar nga



Implentuar nga

eciks | Prishtina
Vienna
Zürich
Management Consulting